

# KOMISIONERI

për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

## Informim Dhe Privatësi



Revista nr.5



[www.idp.al](http://www.idp.al)

**Nr. 5**  
**Qershor 2018**

## Përmbajtja

Editorial.....	faqja 3
Dita e Mbrojtjes së të Dhënave Personale, ceremonia e prezantimit të Pullës Postare.....	faqja 4
Shkolla Dimërore “Informim dhe Privatësi” 2018 .....	faqja 5
Ceremonia me rastin e 10-vjetorit të Zyrës së Komisionerit.....	faqja 6
Balanca mes të drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale.....	faqja 7
Konferenca e Autoriteteve Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave Personale.....	faqja 8
Konferenca IV Kombëtare “Për të Drejtën e Informimit/Për një ligj më të mirë.....	faqja 10
Modernizohet Konventa 108 e Këshillit të Evropës.....	faqja 12
Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave, nis funksionimin	
Bordi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave.....	faqja 13
Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave të BE, ndikimi në vendet e treta.....	faqja 14
Portali “pyetshtetin.al” më pranë qytetarëve për transparencën e Autoriteteve Publike.....	faqja 15
Harmonizimi i legjislacionit kombëtar me sistemin e ri të mbrojtjes së të dhënave në BE.....	faqja 16
15 vjet e Drejta për Informim në Kroaci.....	faqja 16
Mbrojtja e të Dhënave Personale në programin e formimit vazhdues	
të Shkollës së Magjistraturës.....	faqja 17
Leksion në “Shkollën Shqiptare të Studimeve Politike 2018”.....	faqja 17
Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile.....	faqja 17
Takim me zyrtarë të institucioneve të Republikës së Kosovës.....	faqja 18
Takim me një grup gazetarësh nga Republika e Maqedonisë.....	faqja 18
Forumi i Qeverisjes së Internetit në Shqipëri.....	faqja 19
Fushata “Privatësi dhe Siguri”.....	faqja 19
Zyra e Komisionerit kontribuon në fushatën e mbjelljes së pemëve.....	faqja 19

Print:

### Revista “Informim Dhe Privatësi”

Apa Albpartners sh.a.

Përgatitet dhe botohet nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Qershor 2018

Adresa: Rr. “Abdi Toptani”, Nd. 5, Kodi postar 1001, Tiranë

Redaksia: Irma Arapi, Alketa Koja, Redi Skënderaj, Erald Mullaraj

## Editorial

Në 10 mars 2018, Zyra e Komisionerit festoi 10 vjetorin e krijimit të saj. Një rrugëtim jo i lehtë, i karakterizuar me punë dhe vullnet për të krijuar një institucion të konsoliduar e profesional dhe që këtë vit, pati nderin të ishte i përzgjedhuri si organizatori i forumit më të rëndësishëm në nivel evropian, Konferencës Evropiane të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale.

Legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale në Shqipëri është bashkëkohor dhe i vendosur në standardet e akteve të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian. Aktualisht, në një epokë digjitale, shtrohen përditë çështje që kërkojnë zgjidhje. Kemi një proces dinamik dhe reformues përpara, me miratimin e protokollit shtesë për modernizimin e Konventës 108 të Këshillit të Evropës dhe nisjen e zbatimit të Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR), të cilat kërkojnë angazhimin për miratimin e reformave në legjislacionin e mbrojtjes së të dhënave edhe në Shqipëri.

Strategjia e re e Zyrës së Komisionerit, e miratuar këtë vit, mbështetet në këtë realitet dhe parashikon objektiva dhe detyra konkrete, si: Përshtatja e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale me Rregulloren 679/2016 e BE (GDPR) dhe Direktivën 680/2016; Mbrojtja e të dhënave në sektorin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit; Edukimi i të rinjve me të drejtat dhe përgjegjësitë e përdorimit të të dhënave personale në ambientin digjital, etj.

Nga ana tjetër, jemi në vitin e katërt të zbatimit të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe natyrisht, kemi një bilanc dhe eksperiencë pune të konsoliduar. Kemi trajtuar mbi 2000 ankesa, 700 kërkesa për parashtrime drejtuar Autoriteteve Publike dhe 170 vendime, të cilat përbëjnë atë që mund të konsiderohet si jurisprudencë e Komisionerit.

Të sigurt në rrugëtimin tonë për të garantuar transparencë efektive dhe mbrojtje të të dhënave personale, ju ftojmë të lexoni numrin e 5-të Revistës “Informim Dhe Privatësi”.

## 28 Janari, Dita e Mbrojtjes së të Dhënave Personale

28 Janari është Dita e Mbrojtjes së të Dhënave Personale. Në kuadër të festimit të kësaj date, Zyra e Komisionerit prezantoi pullën e emetuar nga Posta Shqiptare.

Pulla “28 Janari–Dita Evropiane e Mbrojtjes së të Dhënave Personale” është një iniciativë e Zyrës së Komisionerit dhe përfaqëson në të gjithë elementët e saj konceptin e mbrojtjes së privatësisë dhe marrëdhënien që ka në ditët e sotme individi me teknologjinë. Komisioni Shtetëror i Pullës Postare vlerësoi kërkesat dhe sugjerimet e Zyrës së Komisionerit, duke e përfshirë pullën në tematikat e parashikuara për t’u emetuar gjatë vitit 2017. Ajo ka përmasa 40×30 mm dhe emisioni përbëhet vetëm nga një njësi me vlerë 2500 lekë. Pulla u hodh në qarkullim për herë të parë në 28 dhjetor 2017.

Ceremonia e prezantimit të pullës shqiptare “28 Janari-Dita Evropiane e Mbrojtjes së të Dhënave Personale” ishte aktiviteti qendror i Javës së Mbrojtjes së të Dhënave Personale 2018.



Në foto, nga e majta në të djathtë: Laert Duraj, Artion Baboçi, Vasilika Hysi, Besnik Dervishi dhe Nexhmi Dumani

Më herët, në kuadër të “Javës së Mbrojtjes së të Dhënave Personale 2018”, në datat 25-27 janar, Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me Universitetin Mesdhetar, organizuan edicionin e parë të Shkollës Dimërore “Informim dhe Privatësi”. Në këtë aktivitet të rëndësishëm morën pjesë mbi 70 studentë dhe staf akademik e administrativ nga Universiteti Mesdhetar, por edhe nga institucione të tjera të arsimit të lartë. Ceremonia e përfundimit të Shkollës dhe diplomimit u zhvillua në mjediset e Galerisë Kombëtare të Arteve.

## Shkolla Dimërore “Informim dhe Privatësi” 2018



Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Der-vishi dhe Rektori i Universitetit Mesdhetar, z. Nexhmi Dumani, nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit mes dy institucioneve, në ditën e hapjes së Shkollës Dimërore “Informim dhe Privatësi”, më 25 janar 2018. Kjo marrëveshje ka për qëllim që të koordinojë kapacitetet për zbatimin e projekteve të përbashkëta, sidomos, në drejtim të projekteve kërkimore-shkencore. Gjatë 3 ditëve të zhvillimit të Shkollës Dimërore “Informim dhe Privatësi” u trajtuan temat dhe çështje për njohjen me të drejtën e informimit, parimet kryesore të mbrojtjes së të dhënave personale, videosurvejimin, privatësinë në kohën e internetit, etj.



## 10 Vjet Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale organizoi një takim festiv me rastin e 10-vjetorit të themelimit të saj. Në mars të vitit 2008, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 9887 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i cili krijoi për herë të parë një institucion të pavaruar për garantimin e të drejtës kushtetuese të mbrojtjes së të dhënave personale. Në shtator të vitit 2014, Kuvendi miratoi ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, duke zgjeruar kompetencat e këtij Autoriteti.

Z. Besnik Dervishi në fjalën e tij, përshkroi rrugëtimin e Zyrës së Komisionerit, duke theksuar sfidat dhe arritjet e institucionit në këta 10 vjet. Duke vlerësuar rolin e Autoritetit, aktivitetin e përshëndetën të ftuarit e nderit znj. Vasilika Hysi, Zv/kryetare e Kuvendit; z. Claus Neukirch, Kreu i Zyrës së Këshillit të Evropës; z. Robert Wilton, Zv/kreu i Prezencës së OSBE; znj. Flora Çabej (Pogaçe), ish-Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale; znj. Ersida Sefa, përfaqësuese e Fondacionit “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” dhe znj. Eralda Methasani (Çani), përfaqësuese e botës akademike.



Pjesë e kësaj ceremonie ishte dhe nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit mes institucionit të Avokatit të Popullit dhe Zyrës së Komisionerit. Në qendër të veprimtarisë së tyre, këto Autoritete kanë garantimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut. Kjo marrëveshje mundëson koordinimin më të mirë të punës mes dy institucioneve, si një detyrë e lënë nga Kuvendi, me fokus të veçantë, fushën e të drejtës për informim. Gjithashtu, marrëveshja parashikon bashkëpunimin e palëve për zbatimin e projekteve të përbashkëta, si dhe shkëmbimin e eksperiencës dhe praktikave më të mira.

## Balanca mes të drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale, takimet rajonale në Korçë dhe Shkodër



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në kuadër të Projektit të bashkëpunimit me Prezencën e OSBE në Shqipëri, organizuan në qytetet e Korçës dhe Shkodrës, takimet rajonale “E drejta për informim dhe mbrojtja e të dhënave personale, njohja me detyrimet e ligjeve respektive”. Aktivitetet kishin për qëllim trajnimin e përfaqësuesve të institucioneve qendrore në nivel vendor, të organeve të vetëqeverisjes vendore, atyre të sistemit të drejtësisë, etj., me balancën ndërmjet këtyre dy të drejtave kushtetuese, në funksion të veprimitarisë së tyre.

Trajnimet kishin në fokus njohjen me ligjin 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe Rekomandimin 11/2016 të Komisionerit për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Pjesëmarrësit u njohën me procesin e trajtimit të kërkesave për të drejtën e informimit nga Autoritetet Publike, dallimin mes të drejtës për akses në të dhënat personale dhe kërkesës për t’u njohur me dokumenta zyrtare sipas legjislacionit për të drejtën e informimit. Trajtimi i rasteve konkrete nga veprimtaria e Zyrës së Komisionerit kishte për qëllim orientimin e duhur në terma praktike, duke theksuar se vendimmarrja e Autoritetit i përmbahet parimit të proporcionalitetit kur ndërthuren këto dy të drejta. Përmbushja e plotë e detyrimeve të legjislacionit në fuqi, nxit dhe forcon kulturën e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike.



## Konferenca e Autoriteteve Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave Personale - Tiranë, 2018

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në datat 3-4 maj 2018 organizoi Konferencën e Autoriteteve Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave, me temë “Mbrojtja e të dhënave – së bashku më mirë” (“Conference of European Data Protection Authorities: Data Protection – Better Together”), edicioni i 28-të. Ky është aktiviteti më i rëndësishëm në këtë fushë në kontinentin evropian dhe zhvillohet për herë të parë në Shqipëri dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor.



Z. Besnik Dervishi në fjalën e tij theksoi se ka nisur procesi i modernizimit të legjislacionit kombëtar sipas standardeve evropiane. “Konferenca zhvillohet në Tiranë, në një rajon, atë të Ballkanit Perëndimor, që është i përfshirë vrullshëm në procesin e integritit. Duke besuar se shpreh vullnetin edhe të vendeve të tjera të rajonit, të përfshira në këtë proces, mendoj se duhet që vullnetit tonë t’i përgjigjen edhe organizmat dhe vendet anëtare të BE, për ta bërë mbrojtjen e të



dhënave personale lider në procesin e integritit për ne dhe të bashkëpunimit sipas GDPR nga ana e vendeve të BE” – vlerësoi Komisioneri.

Punimet e Konferencës i përshëndetën dhe të ftuarit e nderit, znj. Vasilika Hysi, Zv/kryetare e Kuvendit; znj. Senida Mesi, Zv/kryeministre dhe z. Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë.

Në këtë aktivitet u trajtuan tematika dhe çështje që kanë të bëjnë me procesin e zbatimit të Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave në BE dhe përpunimin e tyre në kuadër të veprimtarisë së policisë dhe organeve gjyqësore. Po ashtu, u diskutua për raportin e këtij sistemi të ri rregullator me vendet e treta, si dhe forcimin e bashkëpunimit të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave në monitorimin e shërbimeve inteligjente.







Gjatë punimeve u diskutua dokumenti i përgatitur nga Grupi i Punës për të Ardhmen e Konferencës, ku koordinatori i tij është Zyra e Komisionerit dhe në përbërje të të cilit janë 12 Autoritete. Grupi i Punës u mandatua të vijojë veprimtarinë deri në zhvillimin e edicionit të ardhshëm të Konferencës Evropiane, me qëllim përgatitjen e propozimeve konkrete për modernizimin e rregullave të funksionimit të forumit.



piane, si dhe 6 Autoritete të tjera me statusin e vëzhguesit. Konferenca është organizimi më i lartë e më i rëndësishëm i bashkëpunimit dhe koordinimit të strategjive dhe politikave të Autoriteteve evropiane mbikëqyrëse të së drejtës për mbrojtjen e të dhënave dhe privatësisë. Zyra e Komisionerit është anëtarësuar në këtë forum në vitin 2010.

Organizimi i kësaj Konference në Shqipëri është shprehje e vlerësimit të aktivitetit dhe punës të Zyrës së Komisionerit në arenën ndërkombëtare, si dhe nxitje e ndërtimit e forcimit të rrugëve të bashkëpunimit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë së individit.

Pjesëmarrësit mbajtën prezantime për modernizimin e Konventës 108 të Këshillit të Evropës; unifikimin me standardet evropiane në këtë fushë të sistemeve të tjera rregullatore në botë; përpunimin e të dhënave gjatë veprimtarive humanitare apo dhe raportin që krijohet gjatë përdorimit të tyre në rrjetet sociale, si dhe në llojet e ndryshme të marketingut të drejtpërdrejtë.



Në edicionin e sivjetëm të Konferencës Evropiane morën pjesë rreth 100 titullarë dhe përfaqësues të Autoriteteve evropiane. E quajtur ndryshe edhe Konferenca Pranverore (Spring Conference) ajo është zhvilluar për herë të parë në Hollandë në vitin 1991. Aktualisht, në këtë forum janë anëtarë me të drejtë vote 62 Autoritete kombëtare, rajonale dhe institucione evropiane.



## Konferenca IV Kombëtare “Për të Drejtën e Informimit - Për një ligj më të mirë”




Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në bashkëpunim me Fondacionin “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë”, organizuan Konferencën IV Kombëtare “Për të drejtën e informimit/Për një ligj më të mirë”. Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues dhe koordinatorë të të drejtës për informim të institucioneve qendrore, atyre të pavaruara, të vetëqeverisjes vendore, të sistemit të drejtësisë, të organizatave të shoqërisë civile, të medias, etj. Në Konferencë u vlerësua zbatimi i ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe u trajtuan problematika të konstatuara gjatë përmbushjes së detyrimeve të tij nga Autoritetet Publike.

Z. Besnik Dervishi, në fjalën përshëndetëse theksoi disa prej arritjeve kryesore të punës së institucionit në mbikëqyrjen e ligjit. *“Jemi në vitin e katërt të zbatimit të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, kemi një bilanc dhe eksperiencë pune mbi të cilën mund të mbështetemi dhe të debatojmë. Zyra e Komisionerit ka dhënë kontributin e saj për më shumë transparencë në prokurimet publike, koncesionet, shërbimin shëndetësor, sistemin arsimor, raportet e auditimit, procesin gjyqësor dhe arbitrazhin*



*n d ë r k o m b ë t a r, vendimmarrjen e organit të prokurorisë, rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, etj.” – theksoi në fjalën e tij z. Dervishi.*



Konferencën e përshëndeti z. Andi Dobrush, Drejtor Ekzekutiv i Fondacionit “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë”. Në aktivitet mbajtën prezantime z. Edgar Wagner, ekspert i “Projektit të Binjakëzimit Antikorrupsion”; znj. Eralda Methasani (Çani), pedagoge; znj. Ersida Sefa, përfaqësuese e Fondacionit “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” dhe znj. Ardita Shehaj, Drejtor i Drejtorisë për të Drejtën e Informimit.

Në Konferencë të pranishmit u njohën me 4 dokumenta. I pari u prezantua projekti i amendimeve të mundshme të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Ky moment shërbeu dhe si nisja e procesit

të konsultimit publik për këtë akt. Gjithashtu, u prezantuan edhe iniciativat për përmirësimin e legjislacionit për mundësimin ligjor dhe praktik të komunikimit të drejtpërdrejtë të qytetarëve me institucionet publike, përmes adresimit të kërkesave për informim në rrugë elektronike (portali pyetshetin.al); vlerësimi i kapaciteteve dhe nevojave për forcimin e statusit të koordinatorëve të të drejtës së informimit; si dhe instrumenti i vetëvlerësimit për institucionet e pavarura.

Gjithashtu, u prezantuan edhe iniciativat për përmirësimin e



Nëpërmjet këtyre nismave, synohet që të rritet pjesëmarrja e individit, shoqërisë civile apo medias në procesin e qeverisjes, si një nga elementët kryesorë të luftës kundër korrupsionit. Transparenca dhe llogaridhënia e Autoriteteve Publike është vitale për zhvillimin e demokracisë dhe kultivimi i kësaj kulture është detyrë e të gjitha institucioneve, duke përmirësuar funksionimin e tyre të brendshëm. Njëkohësisht, forcimi i rolit të koordinatorit të të drejtës për

informim rrit përgjegjësinë e përmbushjes në kohë të detyrimeve të ligjit 119/2014, në mënyrë që të zbatohen standarde të unifikuara nga të gjitha Autoritetet Publike për qytetarët shqiptarë.



informim rrit përgjegjësinë e përmbushjes në kohë të detyrimeve të ligjit 119/2014, në mënyrë që të zbatohen standarde të unifikuara nga të gjitha Autoritetet Publike për qytetarët shqiptarë.

## Modernizohet Konventa 108 e Këshillit të Evropës, standarde të larta për mbrojtjen e të dhënave

Ministrat e Jashtëm të vendeve anëtare të Këshillit të Evropës miratuan më 18 maj 2018 Protokollin e modernizimit të Konventës “Për mbrojtjen e individëve nga procedimi automatik i të dhënave personale” të vitit 1981 (Konventa 108 e KiE). Ky dokument është instrumenti më i rëndësishëm ndërkombëtar me fuqi detyruese për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë e individit në hapësirën evropiane e më gjerë dhe është i hapur për t’u nënshkruar edhe nga shtete në kontinente të tjera.



Modernizimi i Konventës i përgjigjet sfidave të zhvillimit ekonomik, social e teknologjik dhe raportit që krijohet me përdorimin e ligjshëm të të dhënave personale. Ky modernizim ka ecur paralelisht me reformën e madhe rregullatore në Bashkimin Evropian (GDPR), pasi diskutimet dhe negociatat për modernizimin e Konventës kanë vijuar për 7 vjet me rradhë. Miratimi i Protokollit (CETS Nr. 223) për modernizimin e saj u bë në mbledhjen e 128-të të Këshillit të Ministrave të Jashtëm të Këshillit të Evropës – që është organizmi më i lartë vendimmarrës i organizatës, të zhvilluar në Danimarkë.

Parashikohet që brenda vitit 2018, të nisë procedura e nënshkrimit/ratifikimit të Protokollit Nr. 223 nga vendet që janë tashmë palë e Konventës. Ndërsa, është vendosur që të gjitha shtetet që duan të bëhen pjesë e këtij komuniteti rishtazi të nënshkruajnë Konventën 108 të modernizuar. Aktualisht, janë 53 vende që e kanë përfshirë atë në sistemet e tyre rregullatore. Këshilli i Ministrave i KiE ka bërë thirrje që të përshejtohet procesi i adoptimit në legjislacionin kombëtar të këtyre ndryshimeve, për të krijuar standarde të unifikuara në garantimin e kësaj të drejte themelore të njeriut.



Shqipëria është anëtare e Këshillit të Evropës prej vitit 1995. Kuvendi e ka adoptuar Konventën 108 dhe Protokollin shtesë nëpërmjet ligjeve nr. 9287, të datës 07.10.2004. Ndërsa, prej vitit 2008, me ligjin nr. 9887 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, është ngritur Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, institucioni përgjegjës për garantimin e kësaj të drejte kushtetuese.

## Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave të BE, nis funksionimin Bordi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave

Hyrja në fuqi më 25 maj 2018 e Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR) në BE, shënon, njëkohësisht, edhe nisjen e funksionimit të Bordit Evropian të Mbrojtjes së të Dhënave (EDPB). Ky është organizmi më i lartë i BE që miraton aktet për mbikëqyrjen e zbatimit të unifikuar të Rregullores së Përgjithshme, në përputhje me nenet 63-76 të saj. Ky forum përbëhet nga titullarët e Autoriteteve kombëtare të Mbrojtjes së të Dhënave të vendeve anëtare të BE dhe Supervizorit Evropian të Mbrojtjes së të Dhënave (EDPS). Ndërsa Komisioni Evropian merr pjesë në mbledhjet



e Bordit, por pa të drejtë vote. Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është anëtare me statusin e vëzhguesit në këtë forum.

*“Në një botë ku të dhënat trajtohen si monedhë, të drejtat e qytetarëve shpesh janë neglizhuar apo lënë në harresë. Ne nuk duhet të harrojmë faktin se individët duan dhe kanë të drejtë të mbrojnë të dhënat e tyre personale”* – vlerësoi znj. Andrea Jelinek, Presidentja e sapozgjedhur e Bordit, njëkohësisht edhe kreu i Autoritetit austriak të Mbrojtjes së të Dhënave Personale. Ky organizëm do të nxisë bashkëpunimin efektiv mes Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe është i mandatuar të zgjidhë me vendime detyruese mosmarrëveshjet në rastet e përpunimit ndërkufitar të të dhënave.

GDPR ka si pika referimi transparencën, përgjegjshmërinë, sigurinë dhe etikën në përpunimin e të dhënave personale. Dokumenti adreson problematika të verifikuara ndër vite nga procesi i përparimit të vrullshëm teknologjik, si pjesë e zhvillimit tërësor ekonomik-social të këtyre vendeve, por dhe më gjerë. Rregullorja e Përgjithshme u jep qytetarëve kontroll mbi të dhënat e tyre, duke u garantuar një gamë të madhe shërbimesh. Parashikohet forcimi i penaliteteve ndaj kontrolluesve, si masë parandaluese për shkeljet në këtë fushë. Rregullorja e Përgjithshme u miratua në prill të vitit 2016, së bashku me Direktivën për transferimin e të dhënave për qëllime të hetimit policor apo gjyqësor. Zyra e Komisionerit ka nisur procesin e adoptimit të GDPR dhe Konvetës 108 të modernizuar në sistemin rregullator kombëtar, për të garantuar trajtim bashkëkohor të kësaj të drejte kushtetuese të qytetarëve shqiptarë.

## Rregullorja e Përgjithshme Mbrojtjes së të Dhënave të BE, ndikimi në vendet e treta



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në bashkëpunim me kompaninë “Ernst&Young”, zhvilluan trajnimin me temë “Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR) e Bashkimit Evropian”. Në këtë trajnim mori pjesë stafi i Zyrës së Komisionerit, ndërsa lektorë ishin z. Milen Raikov dhe znj. Irina Yaneva. Temat e trajnimit kishin të bënin me risitë e legjislacionit të ri evropian në fushën e të dhënave personale, marrëdhëniet mes kontrolluesve dhe

përpunuesve, informimi i subjektit të të dhënave dhe të drejtat e tij. Po ashtu, u trajtuan edhe çështje të sigurisë së përpunimit të të dhënave, përgjegjshmëria në procesin e përpunimit dhe transferimi ndërkombëtar i tyre. “Ernst&Young” është një nga 4 kompanitë më të mëdha botërore në fushën e konsulencës dhe auditimit. Njëkohësisht, Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me



degën shqiptare të kompanisë “Ernst&Young” organizuan aktivitetin “Ndikimi i Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave të BE në sektorin privat në Shqipëri”. Ky takim kishte qëllime informuese dhe ndërgjegjësuese për detyrimet dhe të drejtat shtesë që priten të sjellë kjo Rregullore, jo vetëm për shtetet anëtare të BE, por në shkallë botërore. Gjithashtu, u diskutua për hapat që duhet të përmbushen nga bizneset shqiptare për mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi dhe me Rregulloren e Përgjithshme.

Stafi i Zyrës së Komisionerit informoi të pranishmit për masat që janë marrë dhe që priten të ndërmerren për përshtatjen në legjislacionin shqiptar të Rregullores. Veçanërisht, u prezantuan mekanizmat për mundësinë e certifikimit të kompanive në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, si një nga risitë e GDPR. Të pranishmit u njohën me konceptet, parimet dhe kërkesat e Rregullores së Përgjithshme. Specialistët e “Ernst&Young Albania” paraqitën më tej praktikat më të mira evropiane për zgjidhjen e problematikave të hasura në këtë fushë, si nga këndvështrimi i autoritetit rregullator ashtu edhe ai i bizneseve.

## Portali “pyetshtetin.al” më pranë qytetarëve për transparencën e Autoriteteve Publike

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Fondacioni “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” po bashkëpunojnë në realizimin e projektit për “Regjistrin Kombëtar të Kërkesave dhe Përgjigjeve”, si pjesë e fazës së dytë të portalit “pyetshtetin.al”. Për këtë qëllim është krijuar një sistem, nëpërmjet të cilit qytetarët kanë mundësi bërjen direkt të kërkesës për informacion pranë Autoriteteve Publike dhe ankesës pranë Zyrës së Komisionerit.



Ky sistem është formatuar në mënyrë të tillë që i gjithë procesi i trajtimit të kërkesave apo ankesave të realizohet brenda tij. Fillimisht, prej muajit mars pilotimi i projektit u realizua në 7 Autoritete Publike: Zyra e Komisionerit; Kontrolli i Lartë i Shtetit; Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë; Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Bashkitë e Tiranës, Korçës dhe Shkodrës.



Për njohjen dhe përdorimin e sistemit u zhvilluan trajnime me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe me koordinatorët dhe specialistët e TIK të institucioneve të sipërpërmendura.

Prej muajit qershor, në zbatim të VKM nr. 145, datë 13.3.2018, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Regjistri elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit”, projekti po zbatohet edhe në 20 Autoritete të tjera Publike, institucione të pavarura, qendrore dhe të pushtetit vendor.

Për këtë qëllim, Zyra e Komisionerit dhe Fondacioni “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” vijuan trajnimet për njohjen me elementët teknikë dhe funksionimin e sistemit në praktikë nga koordinatorët dhe specialistët TIK.

Portali “pyetshtetin.al” është një platformë interaktive komunikimi në shërbim të qytetarëve, në funksion prej tre vjetësh.



## Harmonizimi i legjislacionit kombëtar me sistemin e ri të mbrojtjes së të dhënave në BE



Zyra e Komisionerit, në bashkëpunim me Instrumentin e Asistencës Teknike për Shkëmbimin e Informacionit të Bashkimit Evropian (TAIEX) zhvilluan trajnimin e dytë me temë “Harmonizimi i legjislacionit kombëtar me legjislacionin e ri të mbrojtjes së të dhënave personale në BE”.

Në këtë aktivitet i ftuar si lektor ishte z. Tino Naumann, përfaqësues i Autoritetit të Mbrojtjes së të Dhënave Personale të landit të Saksonisë në Gjermani. Gjatë trajnimit 2-ditor morën pjesë përfaqësues të Avokatit të Popullit, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe stafi i Zyrës së Komisionerit. Aktiviteti kishte për qëllim njohjen dhe krahasimin e risive të kuadrit të ri rregullator për mbrojtjen e të dhënave personale në BE, si dhe përafrimin e legjislacionit në këtë fushë në vendet candidate për anëtarësim, pas hyrjes në fuqi të GDPR dhe Direktivës së Policisë.

Ndër çështjet kryesore të trajnimit ishin ato për njohjen dhe respektimin e të drejtave të qytetarëve kur ata janë subjekt i transmetimit/transferimit të të dhënave për qëllime të hetimit policor apo gjyqësor dhe kategoritë e të dhënave që transmetohen/transferohen. Gjithashtu, u trajtua roli i oficerit të mbrojtjes së të dhënave në këto organe (DPO); masat e sigurisë, mënyrat e ruajtjes apo shkatërrimit në procesin e transferimit të të dhënave; si dhe marrëdhëniet mes institucioneve ligjzbatuese në BE me ato në vendet candidate. Nëpërmjet rasteve praktike, u diskutua eksperiencia gjatë periudhës tranzitore për anëtarësim në BE dhe përgatitja e Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave për mbikëqyrjen e zbatimit të Rregullores së Përgjithshme dhe Direktivës së Policisë.

## 15 Vjet e Drejta për Informim në Kroaci

Komisioneri i Informimit të Kroacisë organizoi Konferencën me temë “15 Vjet e Drejta për Informim”, ku e ftuar ishte dhe Zyra e Komisionerit. Me temën “Forcimi i transparencës nëpërmjet bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile”, e cila u mbajt nga znj. Ardita Shehaj, Drejtori i Drejtorisë së të Drejtës për Informim, u prezantua eksperiencia shqiptare në këtë fushë. Ajo i njohu të pranishmit me veprimtarinë për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ku u vlerësua kontributi i OjF për nxitjen dhe ushtrimin e kësaj të drejte themelore të njeriut. Në këtë takim u prezantua edhe portali “pyetshtetin.al”, si një mekanizëm për rritjen e transparencës në Autoritetet Publike. Në aktivitet morën pjesë dhe mbajtën prezantime dhe përfaqësues të institucioneve homologe nga Sllovenia, Mali i Zi e Maqedonia, organizata të shoqërisë civile vendase dhe evropiane, bota akademike, media, etj.





## Mbrojtja e të Dhënave Personale në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës

Në kuadër të Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, u zhvillua në datat 28-29 maj 2018 seminari IV trajnues me temë “Mbrojtja e të dhënave private dhe privatësia në raport me lirinë e shprehjes dhe zhvillimet teknologjike”. I ftuar si lektor në këtë seminar ishte Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi.



Dervishi trajtoi kuadrin rregullator në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale si dhe reformën e ndërmarrë në kuadër të përafërimit të legjislacionit shqiptar me atë të BE. Temat e tjera të prezantuara në trajnim i përkasin “Lirisë së shprehjes në këndvështrimin e të drejtës për informim dhe kufizimet e kësaj lirie në kuadër të mbrojtjes së të dhënave private”, si dhe “Mbrojtja e privatësisë në raport me lirinë e shprehjes”. Gjatë trajnimit u analizuan raste nga jurisprudenca e GJEDNJ dhe GJED. Në këtë seminar morën pjesë gjyqtarë dhe prokurorë nga të gjitha rrethet.

## Leksion në “Shkollën Shqiptare të Studimeve Politike 2018”



Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi, mbajti një leksion në Kursin e 3-të të “Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike 2018”. Tema e këtij takimi ishte “Procesi i integrimit në Bashkimin Evropian, perspektiva e Ballkanit Perëndimor dhe Shqipëria”. Akademia e Studimeve Politike është një organizatë e shoqërisë civile, e cila që prej vitit 2007 ka për qëllim edukimin e një brezi të ri politikanësh, për zbatimin e modeleve më të mira demokratike në Shqipëri.

## Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile

Zyra e Komisionerit zhvilloi një takim informues me përfaqësues të organizatës “Together for Life”. Një nga çështjet kryesore të diskutuara ishte njohja me projektin “Fuqizimi i pacientëve: luftë kundër korrupsionit në sistemin e shëndetësisë përmes fuqizimit të pacientëve dhe institucioneve të pavarura”. Zyra e Komisionerit u angazhua maksimalisht në ofrimin e asistencës për respektimin e kritereve dhe standardeve ligjore. Projekti synon të adresojë dhe ndihmojë në zgjidhjen e problematikave për disa kategori të caktuara shoqërore, të cilat përfaqësohen nga kjo organizatë.



## Takim me zyrtarë të institucioneve të Republikës së Kosovës



Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi, mikpritri një delegacion me zyrtarë të disa institucioneve të Republikës së Kosovës. Takimi i punës kishte në fokus të tij shkëmbimin e eksperiencës dhe asistencën në kuadër të procesit të hartimit të legjislacionit të ri për të drejtën e informimit. Kolegët u njohën me funksionimin e Autoritetit dhe risitë e ligjit 119/2014. Në takim u trajtuan raste që kanë të bëjnë me balancën mes privatësisë dhe respektimin e të drejtës për informim apo transparencën në funksion të reformës dhe ngritjes së organeve të reja të sistemit të drejtësisë. Si aspekte të tjera të rëndësishme të punës së institucionit u vlerësuan kontributi në Strategjinë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike, në Projektin e Binjakëzimit Anti-Korrupsion apo dhe në nismat ndërgjegjëse që zhvillon në vijimësi Zyra e Komisionerit.

## Takim me një grup gazetarësh nga Republika e Maqedonisë



Zyra e Komisionerit mirëpriti në një takim pune një grup gazetarësh, përfaqësues të mediave në Maqedoni. Vizita e tyre pranë Autoritetit ishte pjesë e turit në Shqipëri, i cili fokusohej kryesisht në gazetarinë investigative, në kuadër të shkëmbimit të eksperiencës mes BIRN-Macedonia dhe BIRN-Albania.

Të pranishmit u informuan për rolin dhe funksionet e Zyrës së Komisionerit

në mbikëqyrjen e ligjit “Për të drejtën e informimit”, që së bashku dhe me akte të tjera, përbëjnë kornizën e reformës së ndryshimit të mentalitetit të administratës publike. Në vlerësimin e institucionit, zbatimi i tij ka dhënë rezultate të prekshme për qytetarët, organizatat e shoqërisë civile dhe gazetarët, në respektimin e të drejtës për t’u informuar me dokumentet zyrtare. Në përgjigje të pyetjeve të gazetarëve, Komisioneri theksoi se transparenca dhe llogaridhënia e Autoriteteve Publike ka ardhur gjithnjë duke u përmirësuar. Ky proces kërkon konsolidim të vazhdueshëm, si në pikëpamjen legjislative, ashtu edhe në atë administrative. Zyra e Komisionerit zhvillon aktivitete trajnuese kombëtare dhe rajonale, duke iu ofruar asistencën e nevojshme Autoriteteve Publike për zbatimin e detyrimeve ligjore. Numri më i madh i ankesave i përket OjF dhe organeve të medias dhe në vlerësimin e institucionit, bashkëpunimi me to është i rëndësishëm, duke qënë se objektivi është i përbashkët – transparenca e Autoriteteve Publike.

## Forumi i Qeverisjes së Internetit në Shqipëri



Internet Governance Forum-Forumi i Qeverisjes së Internetit, është një iniciativë e shoqërisë civile, e miratuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara dhe që mbikëqyret nga një Sekretariat i posaçëm (UN-IGF Secretariat). Nisma nxit bashkëpunimin e sektorit publik me atë privat për krijimin e standardeve rregullatore. Në takimin e parë, të zhvilluar në mjediset e Qendrës COD në Kryeministri, morën pjesë përfaqësues nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti

Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, Sekretariati i OKB për Qeverisjen e Internetit, bota akademike, shoqëria civile, kompani të ndryshme të sektorit TIK dhe grupe interesi, media, etj. Tematikat ku u fokusua takimi ishin qeverisja e internetit parë në optikën e perspektivës së zhvillimit të fushës në vendin tonë, si dhe sfidat e sigurisë kibernetike. Zyra e Komisionerit u përfaqësua në këtë forum nga znj. Pjerina Gaxha, Drejtor i Drejtorisë së Mbrojtjes së të Dhënave Personale. Ajo i njohu të pranishmit me funksionet mbikëqyrëse të Autoritetit në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe qasjen ndërgjegjëse për qytetarët për përdorimin e sigurt të internetit dhe rrjeteve sociale.

### Fushata “Privatësi dhe Siguri”

Në kuadër të fushatës ndërgjegjëse “Privatësi dhe Siguri”, Zyra e Komisionerit zhvilloi disa takime në institucione të arsimit 9-vjeçar në Durrës, Lushnjë, Berat e Tiranë. Qëllimi i tyre ishte konsultimi i “Kadrit të aftësimit të mësuesve për mbrojtjen e të dhënave personale”. Në këto trajnime pjesëmarrës ishin mësues të lëndëve të edukatës shoqërore, TIK dhe psikologë.

“Kadri i aftësimit” përmban 9 parime për edukim të përgjegjshëm dhe për rritjen e sigurisë në mjedisin digjital. Mësimdhënësit marrin njohuritë bazë për mbrojtjen e privatësisë; për legjislacionin e fushës - qëllimin, mënyrat dhe mjetet e përpunimit të të dhënave personale; të drejtat e individit në rastet e keqpërdorimit të tyre, si dhe me çështje që kanë të bëjnë me aspekte teknike të sigurisë së të dhënave. Fushata po zhvillohet me kontributin dhe mbështetjen e DAR/ZA, ndërkohë që ky dokument është miratuar në 2016, në Konferencën e 38-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Privatësisë.



Lushnjë

### Zyra e Komisionerit kontribuon në fushatën e mbjelljes së pemëve

Në Ditën Ndërkombëtare të Tokës, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil iu bashkuan nismës së Kryetarit të Bashkisë së Tiranës për gjelbërimin e kryeqytetit.

Komisioneri Dervishi, e vlerësoi këtë iniciativë si “një nismë e mrekullueshme e kryetarit të Bashkisë, e Bashkisë së Tiranës, dhe mendoj se kemi gjetur pikërisht atë çfarë dëshirojnë familjet dhe fëmijët tanë për të ardhmen e Tiranës”.



# KOMISIONERI

për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

## Informim Dhe Privatësi

Revista nr.5



Adresa:  
Rr. "Abdi Toptani", Nd. 5,  
Kodi postar 1001, Tiranë  
E-mail: [info@idp.al](mailto:info@idp.al)  
TEL: +35542237200  
FAX: +35542233977  
Nr. i Gjelbër: 08002050

[www.idp.al](http://www.idp.al)